# AKADEMIA PËR GJYKATËS DHE PROKURORË PUBLIK

Llojë i revizionit: Revizioni i raporteve financiare dhe revizioni i pajtueshmërisë

Periudha: 2024

Mendimi i shprehur

Raportet financiare: 603 787

Numri i llogarisë: 2

Pajtueshmëria: 603 787

## Gjendjet kyçe të konstatuara:

- pagesat e kompensimeve për anëtarët e Këshillit Drejtues dhe të Këshillit Programor kryhen çdo muaj dhe në tërësi, dhe jo në mënyrë proporcionale me pjesëmarrjen në mbledhje për muajt në të cilët është mbajtur mbledhja;
- afati ligjor i përcaktuar për përfundimin e fazës së dytë të trajnimit fillestar për gjeneratën e 8-të të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë publikë është tejkaluar për 3 muaj, që ka rezultuar me pagesën e mjeteve shtesë financiare për mentorët dhe koordinatorët;
- një pjesë e kontratave me mentorët për realizimin e mësimit praktik janë lidhur pas përfundimit të periudhës së mentorimit;
- janë paguar mjete për koordinatorë, statusi, të drejtat dhe detyrimet e të cilëve nuk janë të përcaktuara me Ligjin për Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë;
- anëtarëve të komisioneve për vlerësimin e mësimit praktik u janë paguar kompensime, edhe pse e drejta dhe pagesa e kompensimeve për vlerësimin e mësimit praktik nuk janë të përcaktuara me Ligjin për Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë;;
- tejkalimi i maksimumit ligjor të përcaktuar për punën jashtë orarit dhe moskryerja e njoftimit paraprak me shkrim tek inspektori rajonal i punës për angazhimin e punonjësve në punë jashtë orarit.
- janë paguar mjete për punë jashtë orarit për një person të punësuar në ditë për të cilat atij i janë paguar edhe mëditje për udhëtim zyrtar jashtë vendit dhe për pjesëmarrje në mbledhje që është mbajtur gjatë orarit të plotë të punës;
- nuk është vendosur evidencë, përkatësisht ngarkim i personave përgjegjës, nga e cila do të mund të përcaktohet se kujt dhe për çfarë qëllimi i lëshohen kartelat e karburantit;
- në dokumentacionin e tenderit është përcaktuar një kriter që nuk lidhet drejtpërdrejt me lëndën e prokurimit, por që duhet të përmbushet nga operatori ekonomik;
- janë furnizuar mallra dhe shërbime pa u zbatuar procedura e prokurimit publik dhe
- njoftojmë për arkëtimin e kompensimit për shpenzimet e dhënies së provimit pranues në bazë të Rregullores për dhënien e provimit pranues në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë „Pavel Shatev“.

Rekomandimet e dhëna: 9

Vërejtjet e dorëzuara: Po √ Jo

Përgjigjet e vërejtjeve: Po √ Jo

Link deri te raporti i revizionit:

Mendimi pozitiv | Mendimi me rezervë | Mendim të pavolitshëm | I përmbajtur në dhënjen e mendimit